

Efikasiteti i politikës monetare dhe zëvendësimi i monedhës sipas Marrëveshjes së Tryezës së Monedhës në Bosnje-Hercegovinë

(Përvoja e një vendi – Përqasje ndaj politikës monetare – Përvoja e Bosnje-Hercegovinës)

Dragan Kovačević – Zëvendësguvernator i Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës

Hyrje

Bosnje-Hercegovina është një vend i vogël që vuajti mjaft nga lufta dhe u përball me tre procese kryesore, të njëpasnjëshme tranzicioni:

- kalimi nga lufta në paqe;
- kalimi nga një ekonomi e komanduar socialiste e dominuar nga shteti në një ekonomi të sektorit privat, e drejtuar nga tregu; dhe
- kalimi nga qenia pjesë e një kombi të madh në një vend të pavarur, me institucionet e tij vendase dhe administrative.

Vetëm një nga këto procese tranzicioni është jashtëzakonisht sfidues në vetvete. Në fazën e parë të procesit të reformës, Shtetit të [Bosnje-Hercegovinës](#) i duhej të siguronte disa mbështetje të qëndrueshmërisë ekonomike. Një nga këto mbështetje, të cilën na e ofron përvoja e [Bosnje-Hercegovinës](#) dhe që mund të ndiqet me sukses dhe relativisht shpejt, është një monedhë e qëndrueshme.

POLITIKA MONETARE – Marrëveshja e *Currency Board* në Bosnje-Hercegovinë.

Kuadri i politikës monetare është përcaktuar si marrëveshja për *Currency Board*, sipas Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit për Bosnje-Hercegovinën, në vitin 1995.

Kuadri institucional dhe ligjor i këtij sistemi monetar është përcaktuar sipas ligjit “Për Bankën Qendrore të Bosnje-Hercegovinës”, që u miratua nga Parlamenti i Bosnje-Hercegovinës.

Ligji përcakton se banka qendrore nuk duhet të përfshihet në asnjë operacion në tregjet e parasë dhe kapitalit dhe se ajo nuk duhet t'i japë kredi asnjë sektori, përfshirë edhe sektorët bankarë dhe qeveritarë.

Grupi drejtues i Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës quhet Bordi Drejtues, është i përbërë nga 4 anëtarë. 3 anëtarë janë nga kombet që jetojnë në Bosnje-Hercegovinë (serb, kroat, boshnjak) dhe anëtari, i cili nuk është nga Bosnie-Hercegovina, është Kryetari i Bordit Drejtues. Është përcaktuar që Bordi Drejtues duhet të ketë një strukturë të tillë në 6 vitet e para të veprimtarisë së Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës. Nga gushti i këtij viti ne kemi pesë anëtarë vendas të Bordit Drejtues. Ligji siguron pavarësinë e

Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës. Banka Qendrore e Bosnje-Hercegovinës nisi veprimtarinë e saj në 11 gusht 1997.

PARIMET E POLITIKËS MONETARE

Marrëveshja e *Currency Board* në Bosnje-Hercegovinë parashikon:

- Mbulimin e plotë të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës nëpërmjet rezervës së huaj valutore.
- Kurs këmbimi fiks në lidhje me monedhën e fiksuar, Marka Gjermane (1 KM = 1dem).

Që nga 1 janari i vitit 2002, km i është përshtatur euros kundrejt kursit të këmbimit 1 euro = 1,955830 km, domethënë 1 km = 0,511292 euro.

- Konvertim i pakufizuar i markës së konvertueshme.

EFEKET E POLITIKËS MONETARE

Që nga fillimi i operacioneve të Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës, kuadri ligjor i përcaktuar për zbatimin e politikës monetare, është zbatuar tërësisht:


- Parimi i *Currency Board* është respektuar plotësisht.
- Qëndrueshmëria e monedhës vendase është siguruar.
- Monedha vendase është këmbyer kundrejt monedhës së fiksuar pa kufizime.
- Rezervat e valutës së huaj janë në rritje.
- Prani e plotë e km në transaksionet e pagesave vendase.
- Nivel i ulët i inflacionit.

Rezultatet dhe efektet e politikës monetare mund të shihen në vrojtimet dhe në analizat e mëposhtme.

Aktivet e Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës janë rritur vazhdimisht gjatë gjithë periudhës që nga fillimi i operacioneve. Në fund të vitit 2002, ato arritën në 2,465 miliardë km (në fillim të operacioneve të Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës ato ishin 132 milionë km), ndërsa rezervat neto të lira ishin (diferenca ndërmjet rezervës neto të valutës së huaj dhe detyrimeve monetare të Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës) mbi 118 milionë km.

Diagramë 1.

Rezerva neto e valutës së huaj.



INFLACIONI


Në periudhën që fillon me prezantimin e *Currency Board*, niveli i inflacionit në Bosnje-Hercegovinë ka shënuar një tendencë të ndjeshme rënëse, dhe ishte nën 1 për qind në vitet 2001 dhe 2002 (tabela 1 dhe diagrama 2.).

Tabelë 1. Tendencat e inflacionit në Bosnje-Hercegovinë.

Niveli i inflacionit në vitet	1998	1999	2000	2001	2002
Federata e Bosnje-Hercegovinës	1,8	-1,0	4,0	0,3	-0,2
Republika Serbe	78,1	14,0	16,1	2,2	1,7
Totali i Bosnje-Hercegovinës*	27,2	4,0	8,0	0,9	0,4
*Inflacioni i matur sipas veprimtarisë					

Niveli inflacionit në Bosnje-Hercegovinë.

Diagramë 2.



Shitblerja e KM.

Marka e konvertueshme shitet dhe blihet pa kufizime.

Në fillim të operacioneve të Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës, në vitin 1997, në Bosnje-Hercegovinë përdorehin katër monedha: km, dem, kuna kroate dhe dinari jugosllav. Marka gjermane, kuna kroate dhe dinari jugosllav u përjashtuan nga sistemi i pagesave në tremujorin e katërt të vitit 1999. Në fund të vitit 1999, 14,5 milionë dem, 1,4 milionë kuna kroate dhe 2,4 milionë dinarë jugosllavë ishin në sistemin e pagesave, shumat e të cilave u llogaritën në km.

Ndarja e këtyre katër monedhave në totalin e transaksioneve të pagesave, në fund të vitit arriti në 25,5 për qind. Përdorimi i kunës kroate dhe i dem, pushoi së vepruari faktikisht në vitin 2000 në Federatën e Bosnje-Hercegovinës, ndërsa dinari jugosllav doli nga përdorimi në Republikën Serbe të Bosnje-Hercegovinës në qershor të vitit 2000, si edhe dem.


Rritja e besimit në km dhe rritja e përdorimit të saj, tregohen në të dhënat e mëposhtme:

Në vitin 2002, shitja e km arriti nivelin e 10,4 milionë km, ndërsa blerja arriti 8,3 miliardë km; (diagrama 3). Shitblerja e km është e mundur sot përveçse në Bosnje-Hercegovinë, në Austri, në Zvicër, në Gjermani, në Republikën Çeke, në Kroaci, në Hungari, në Sllovaki, në Slloveni dhe në Serbi e Mal të Zi. Bilanci i shitblerjes arriti në 2,1 miliardë.

Përgjatë gjithë periudhës, niveli i përdorimit të km në sistemin e pagesave të Bosnje-Hercegovinës ishte në rritje (diagrama4).


Diagramë 3.

Shitblerja e km



km në qarkullim.

Diagramë 4.



Qëndrueshmëria e kursit të këmbimit dhe e nivelit të inflacionit të një vendi, janë përfitime ekonomike jashtëzakonisht të rëndësishme për:

- tërheqjen e vizitorëve;

- zhvillimin e sektorit financiar.
- Qëndrueshmëria e kursit të këmbimit dhe niveli i inflacionit të një vendi u jep mundësi njerëzve të planifikojnë vendimet e tyre ekonomike për të ardhmen me më shumë besim. Kjo ka rëndësi të veçantë për investimet sepse të ardhurat ekonomike nga çdo investim shpërndahen përgjatë shumë viteve. Ky përfitim u takon si investitorëve vendas ashtu dhe atyre të huaj.

Qëndrueshmëria e inflacionit dhe e kursit të këmbimit janë gjithashtu, mjaft të rëndësishme për zhvillimin e sektorit financiar. Për momentin, rreziku kryesor tek i cili bankat duhet të përqendrohen është rreziku i huamarrësve të tyre. Ky është ende një problem i madh në Bosnje-Hercegovinë, veçanërisht në sektorin e biznesit. Kjo është dhe arsyeja kryesore se pse bankat u japin më tepër hua individëve sesa sektorit të biznesit.

Por, duke qenë se rreziku i kreditimit është tashmë zona kryesore e rrezikut financiar për huadhënien bankare në Bosnje-Hercegovinë, për autoritetet, për bankat dhe për sektorin e biznesit, këto mund të punojnë së bashku për të zhvilluar politika që ta reduktojnë sa më shumë atë. Sektori bankar në Bosnje-Hercegovinë ka bërë një progres të jashtëzakonshëm përgjatë tre viteve të fundit. Cilësia e bankave është përmirësuar dhe shumica e bilanceve të tyre janë më të fuqishme. Llojshmëria e shërbimeve që ofrojnë, është rritur dhe niveli i interesave mbi huatë ka rënë ndjeshëm.

Bosnje-Hercegovina është një vend i vogël; ajo ka një bilanc të madh të deficitit tregtar; ajo ka nevoja të jashtëzakonshme për zhvillim me qëllim që të përmirësojë standardin e jetesës për qytetarët e saj. Të gjitha këto nënkuptojnë se Bosnje-Hercegovina ka nevojë themelore për investime, përfshirë investimet private të huaja. Por, ato nuk ka pse vijinë në Bosnje-Hercegovinë. Atje ka ende një shkallë të ndjeshme rreziku politik dhe biznesi për të investuar. *Currency Board* ka mundësuar një qëndrueshmëri të kursit të këmbimit dhe një inflacion të ulët. Këta janë faktorët më pozitivë që ka tashmë Bosnje-Hercegovina për të bindur investitorët e huaj të mundshëm që të sjellin kapitalin e tyre në Bosnje-Hercegovinë.

Qëndrueshmëria e monedhës vendase dhe transparenca e politikës monetare brenda *Currency Board* në Bosnje-Hercegovinë, kanë kontribuar mjaft në zhvillimin e sektorit bankar dhe në kthimin e besimit tek bankat. Kjo është manifestuar nëpërmjet rënies së numrit të bankave (shkurtimi i sektorit bankar) dhe ndryshimit të strukturës së pronësisë në banka. (tabelat 2 dhe 3).

Në fund të vitit 2002, në Bosnje-Hercegovinë vepronin 40 banka, 8 më pak se në vitin 2001. Në vitin 1990, kishte 61 banka që vepronin në Bosnje-Hercegovinë. Numri i bankave, si dhe struktura e pronësisë, jepet si më poshtë.

Tabelë 2: Struktura e pronësisë në banka.

	31.12.2000	31. 12. 2001	31.12.2002
Banka shtetërore	19	12	6
Banka private	36	34	34
Nga kjo:			
Totali	55	48	40

Struktura e gjendjes së kapitalit jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 3: Struktura e gjendjes së kapitalit në banka, në milionë km.

	31.12.02	31.12.02	31.12.02	31.12.02	31.12.02	31.12.02
	Sasia	Përpjestimi	Sasia	Përpjestimi	Sasia	Përpjestimi
Totali gjendjes së kapitalit	658	100%	627	100%	745	100%
Kapitali shtetëror	307	47%	119	19%	72	10%
Kapitali privat	351	53%	505	81%	671	90%
Nga kjo:						
Kapitali i huaj	135	38	346	68	494	74
Kapitali vendas	216	62	159	32	177	26
	351	100%	505	100%	671	100%

Pjesëmarrja e kapitalit të huaj në totalin e gjendjes së kapitalit është 66 për qind, ndërsa pjesëmarrja e kapitali të huaj në atë privat është 74 për qind.

Huatë

- Totali i huave të dhëna në vitin 2002 arriti në 3.213 milionë km dhe ato ishin 53 për qind më të larta krahasuar me fundvitin 2001.
- Duke parë strukturën e huave sipas sektorëve, 41 për qind e zënë huatë e kompanive private, 44 për qind huatë e qytetarëve, 11 për qind huatë e sipërmarrjeve publike dhe 4 për qind huatë në sektorët e tjerë.

- Huatë e qytetarëve shënuan një rritje të ndjeshme prej 118 për qind, ato të kompanive private u rritën me 32 për qind dhe ato të sipërmarrjeve publike me 3 për qind.

Struktura e huave jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 4: Struktura e huave.

	31.12.02	31.12.02	31.12.02	31.12.02	31.12.02	31.12.02
	Sasia	Përqindja	Sasia	Përqindja	Sasia	Përqindja
Totali i huave	1652	100%	2101	100%	3213	100%
Kompanitë private	833	50%	988	47%	1304	41%
Sipërmarrjet publike	322	20%	350	16%	361	11%
Qytetarët	375	23%	647	31%	1415	44%
Sektorët e tjerë	122	7%	116	6%	133	4%

Vetëm banka qendrore, brenda *currency board* mund të përdorë si instrument monetar rezervën e detyruar.

Bilanci i Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës është:

Aktive	Detyrime
Aktive të huaja neto	Cash-i në qarkullim Rezerva e detyruar e bankës

Funksione të tjera të Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës.

Banka Qendrore e Bosnje-Hercegovinës luan tashmë një rol tjetër shtesë në sektorin financiar të Bosnje-Hercegovinës:

-Ne, Banka Qendrore e Bosnje-Hercegovinës, operojmë me sistemin e kleringut dhe pagesës për sistemin e pagesave jo *cash*. Banka ka mundësinë të zgjerojë rolin e saj të kleringut dhe të pagesave me zhvillimin e mëtejshëm të sistemit financiar në Bosnje-Hercegovinë.

-Ne ofrojmë shërbime bankare për Shtetin e Bosnje-Hercegovinës dhe për institucionet financiare ndërkombëtare; disa nivele të tjera të qeverisë kanë vendosur të përdorin gjithashtu, disa shërbime bankare të Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës.

-Ne, luajmë një rol ndërlidhës në mbikëqyrjen bankare.

Currency board në Bosnje-Hercegovinë në të ardhmen:

- Arsyet kryesore që *Currency Board* duhet të mbahet si politika monetare e Bosnje-Hercegovinës është, se ajo po sjell përfitime ekonomike dhe sociale të vërteta. Shtetasit e Bosnje-Hercegovinës e shikojnë këtë.

- Arsyeya e dytë për të mbajtur përqasjen e *currency board* në politikën monetare është se shumica e vendeve të rajonit tashmë kanë një nivel të lartë të qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit kundrejt euros.
- Arsyeya e tretë e rëndësishme se pse *currency board* duhet mbajtur në Bosnje-Hercegovinë është se nuk ka alternativë më të arsyeshme, po të kemi parasysh gjendjen aktuale të ekonomisë dhe institucioneve të saj.
- Arsyeya e fundit se pse *currency board* duhet mbajtur është se synimi afatgjatë i politikës së Bosnje-Hercegovinës është ta çojë ekonominë më afër dhe rrjedhimisht brenda Evropës.

Përfundim

Përqasja e *currency board* në politikën monetare ka arritur synimin që iu kërkua të arrinte: qëndrueshmëri financiare në Bosnje-Hercegovinë. Kjo i ka sjellë përfitime të konsiderueshme ekonomike dhe sociale ekonomisë dhe qytetarëve.

Currency board duhet të vazhdohet sepse është e rëndësishme mbajtja e qëndrueshmërisë së sektorit financiar. Qëndrueshmëria financiare nuk është një synim që arrihet një herë dhe më pas kalon në një objektiv tjetër. Qëndrueshmëria e sektorit financiar duhet mbajtur me anë të një zbatimi të qëndrueshëm të politikës monetare.

Por është gjithashtu, e mundur për një bankë qendrore që operon si një *currency board* të mbartë role të tjera të sektorit financiar, që do të ndihmonin zhvillimin ekonomik – me kushtin e fortë se politikat e tjera nuk duhet të rrezikojnë asnjëherë *currency board*. Banka Qendrore e Bosnje-Hercegovinës e zbaton këtë në sistemin e pagesave dhe në banka. Ne do të vazhdojmë të zgjerojmë rolin tonë në sektorin financiar të Bosnje-Hercegovinës duke kujtuar gjithmonë se synimi ynë kryesor është të rrisim në maksimum qëndrueshmërinë financiare duke vepruar si një *currency board*.